



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.49/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Hajriz Hoti, dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 23.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET E BAZUAR ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, ZAnr.49/2025 datë 20.09.2025.

II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5.500.00, Euro (PesëmijëepesqindEuro) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 20.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se me datë 19.09.2025, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj, kanë vërejtur se: kandidati për kryetar të Komunës së Skenderajt nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), z.Sami Lushtaku në tubimin me qytetarë të mbajtur në këtë qytet me datë 19.09.2025, për qëllime elektorale, fitimit të votave ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese që mund të nxisin akte dhune ndaj kundërshtarëve politik respektivisht anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndër të tjera i lartcekuri në tubimin me qytetar ka deklaruar : “Qeveri më të poshtër,

Qeveri ma mashtruese, Qeveri më antikombëtare nuk besoj që ka me pas Kosova”. Fjalimi i sipërpërmendur është publikuar dhe shpërndarë në media elektronike dhe në platformën Youtube.com. Si provë që dëshmon shkeljen e pretenduar ka bashkangjitur linkun <https://www.youtube.com/watch?v=H4IU3JyqQnc&t=158s>.

Në përgjigje në ankesë të parashtruar me datë 21.09.2025 nga aan e subjektit politik PDK ka theksuar se deklarata e z.Lushtaku është një kritikë e ashpër ndaj Qeverisë së Kosovës si institucion dhe jo ndaj individëve të caktuar që e përbëjnë atë. Ky është një element kyç që duhet të merret parasysh, pasi diskutimi dhe kritika ndaj institucioneve qeveritare janë pjesë e debatit të zakonshëm politik dhe demokratik, dhe nuk duhet ngatërruar me sulme personale ndaj individëve. Më tutje ka cekur se kur z. Lushtaku përdor këtë gjuhë të fortë, ai i referohet politikave dhe veprimeve të qeverisë, si një strukturë kolektive, e cila është përgjegjëse për vendimmarrjen dhe udhëheqjen e vendit. Kjo është një shprehje e mendimit të tij në lidhje me veprimet e këtij institucioni dhe nuk ka për qëllim të ofendojë ose të dëmtojë individët që mund të jenë pjesë e kësaj qeverie. Kritika ndaj qeverisë si institucion është e lejuar dhe madje e nevojshme në një sistem demokratik, ku individët dhe figurat publike mund të shprehin mendimet e tyre për politikën dhe vendimet që merren në nivel qeveritar. Për më tepër, edhe në rast se do të konsiderohej gjuha e përdorur si e papranueshme, ato deklarata nuk janë drejtuar ndaj kundërshtarëve politikë, por ndaj Qeverisë qendrore të Kosovës, e cila është një institucion dhe jo një palë direkte në këto zgjedhje. Sipas këtij konteksti, deklaratat e bëra janë pjesë e debatit dhe kritikës politike, dhe jo një sulm personal ndaj individëve që mund të jenë pjesë e kësaj qeverie. Bazuar në të lartë përmendurat, propozojmë që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të provave përkatësisht link-ut të ofruar si provë materiale, ka vërejtur se në tubimin e subjektit politik PDK të mbajtur në Skenderaj, kandidati për kryetar të komunës së Skenderaj, Sami Lushtaku, në tubimin me qytetarë të mbajtur në këtë qytet me datë 19.09.2025, për qëllime elektorale, ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese, duke deklaruar “Qeveri më të poshtër, Qeveri ma mashtruese, Qeveri më antikombëtare nuk besoj që ka me pas Kosova”. Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.”.*

Neni 120 par.1 nën par. 1.3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës thekson se në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Sipas Panelit nga përmbajtja e videos shihet se në veprimet e kandidatit Sami Lushtaku nga subjekti politik PDK, kandidat për kryetar komune të Skenderaj, ka përdorë gjuhë fyese, nxitëse dhe urrejtëse kundrejt të tjerëve dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët e tyre janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë kanë për qëllim të dëmtojë procesin – demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme, dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se veprimet e tilla të kandidatit të subjektit politik PDK janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre, dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike, dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim : natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë për bazë praktikën e PZAP-it, e cila ka vendosur për rastet të ngjashme të fjalëve të përdorura gjatë fushatës zgjedhore nga ana e Subjekteve Politike, dhe atë vendimin Anr.27/2025 datë 15.01.2025, në të cilin vendim të PZAP-it, i është shqiptuar gjoja subjektit politik për arsye se kandidatët e Subjektit Politik, gjatë tubimit zgjedhor kanë përdorur fjalë *“duhet me hekë mashtruesin” dhe “dojmë po ashtu me e rrit mbrojtjen, nuk dojmë me bo lojna me sigurinë nacionale pas shpinës së aleatëve tonë...”*, i cili vendim i PZAP-it, Anr.27/2025 datë 15.01.2025, është vërtetuar me Aktgjykim të Gjykatës Supreme AA.nr.34/2025 datë 05.02.2025.

Njëherit paneli i PZAP-it, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi morri për bazë edhe vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut Sanchez kundër Francës [DHM], kërkesa nr. 45581/15, Vendimi gjyqësor i datës 15 maj 2023, në të cilin vendim ndër të tjera thuhet se : *“Megjithatë, liria e debatit politik mund të kufizohet për të penalizuar apo edhe për të parandaluar të gjitha format e shprehjes që propagandojnë, inkurajojnë, nxisin ose justifikojnë urrejtjen bazuar në intolerance...”*.

Në nenin 10 par.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndër të tjera thuhet se *“Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes...”*, ndërsa në paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës ndër të tjera thuhet se *“Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme ... për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve...”*.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën 1.11, neni 118 par.1, dhe neni 120 par. 1 nën par. 1.3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZI.Anr. 49/2025 më datë 23.01.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.84/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Rustem Thaqi dhe Delushe Halimi, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.49/2025, të datës 23.09.2025, në seancën e mbajtur më datë 26.09.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET si e themeltë ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZL.Anr.49/2025, i datës 23.09.2025, dhe vendoset ashtu që: Refuzohet e pathemeltë ankesa e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ZAnr.49/2025 e datës 20.09.2025.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.49/2025, të datës 23.09.2025, ka vendosur: I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZAnr.49/2025 e datës 20.09.2025. II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5.500.00, €. III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të aprovojë ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe të shpallë të paligjshëm vendimin ZL.Anr.49/2025 të PZAP.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thënie ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.Anr.49/2025, i datës 23.09.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezultoi se më datë 20.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.49/2025, të datës 23.09.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli, pas shikimit të provave përkatësisht link-ut të ofruar si provë materiale, ka vërejtur se në tubimin e subjektit politik PDK, të mbajtur në Skenderaj, kandidati për kryetar të Komunës së Skenderaj, Sami Lushtaku, në tubimin me qytetarë të mbajtur në këtë qytet më datë 19.09.2025, për qëllime elektorale, ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese, duke deklaruar “Qeveri më të poshtër, Qeveri ma mashtruese, Qeveri më antikombëtare nuk besoj që ka me pas Kosova”. Andaj për Panelin përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsë si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Ka shtuar se neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës thekson se në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) €.

Sipas Panelit nga përmbajtja e videos shihet se në veprimet e kandidatit Sami Lushtaku nga subjekti politik PDK, kandidat për kryetar komune të Skenderaj, ka përdorë gjuhë fyese, nxitëse dhe urrejtëse kundrejt të tjerëve dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore, konteksti dhe masa që i është drejtuar ka për qëllim të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët e tyre janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprimet që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosferë



destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë kanë për qëllim të dëmtojë procesin demokratik dhe të risë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme, dhe të drejtëpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se veprimet e tilla të kandidatit të subjektit politik PDK janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre, dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike, dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me aprovimin e ankesës të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, bazuar në provat e administruara, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar në tërësi ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të vendimit të PZAP-së për arsye se:

Me provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë ankesa së bashku me dëshmitë e ofruara të paraqitura në PZAP, si dhe ankesa drejtuar kësaj gjykate, shihet qartë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet se: “1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës konkretisht dëshmitë e ofruara me ankesë shihet se kandidati për kryetar të Komunës së Skenderaj, Sami Lushtaku, në tubimin me qytetarë të mbajtur në këtë qytet më datë 19.09.2025, për qëllime elektorale, ka deklaruar: “Qeveri më të poshtër, Qeveri ma mashtruese, Qeveri më antikombëtare nuk besoj që ka me pas Kosova”.

Nga deklaratimet e cituara Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11 të LZP-së. Deklarimet e theksuara gjatë fushatës nuk përmbajnë fjalor që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose



provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve. Përmes këtyre deklarimeve të kandidati në fjalë, shihet qartë se fjalët e përdorua këtu nuk janë të drejtuara kundrejt një subjekti politik të caktuar, në mënyrë që të ngjall apo nxit urrejtje ndaj tyre. Në këto deklarim në asnjë moment nuk kemi thirrje apo nxitje që të ndërmerret veprime të caktuara kundër këtyre subjekteve caktuara.

Përveç të cekurave duhet theksuar se nëse i referohemi gjuha e urrejtjes sipas Strategjisë dhe Planit të veprimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara - OKB-së, rezulton se:

Nuk ka përkufizim universal apo të njëjtë rreth gjuhës se urrejtjes por nëse shikohet nga konteksti ndërkombëtar respektivisht nga OKB-ja, si organizata me e madhe botërore, atëherë gjuha e urrejtjes përkufizohet si: “Çdo lloj komunikimi në të folur, shkrim ose sjellje që sulmon ose përdor gjuhë poshtëruese ose diskriminuese duke iu referuar një personi ose një grupi në bazë të asaj se kush janë me fjalë të tjera bazuar në fenë, përkatësinë etnike, kombësinë, racën, ngjyrën, prejardhjen, gjininë ose faktor tjetër identiteti”.

Sipas Parimeve dhe Udhëzimeve për një qasje gjithëpërfshirëse për të luftuar gjuhën e Urrejtjes shtojcës së rekomandimit CM/REC (2022)16 të Këshillit të Evropës, gjuha e urrejtjes kuptohet si të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal, real ose të atribuuar si “raca, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual”.

Në anën tjetër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - GJEDNJ, në praktiken e saj gjyqësore, lidhur me deklaratimet gjatë fushatës zgjedhore deri me tani ka trajtuar një sërë çështjesh në lidhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj-Konventës.

GJEDNJ, ka theksuar se ekziston një lidhje të ngushtë ndërmjet të drejtës për zgjedhje të lira dhe lirisë së shprehjes. Në rastin Boëman kundër Mbretërisë së Bashkuar, ka theksuar se këto të drejta, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Të dy këto të drejta janë të ndërlidhura dhe funksionojnë për të përforcuar njëra-tjetrën: për shembull, liria e shprehjes është një nga “kushtet” e nevojshme për të “siguruar shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës”. Zgjedhjet e lira dhe liria e shprehjes, veçanërisht liria e debatit politik, së bashku përbëjnë themelin e çdo sistemi demokratik. Për këtë arsye, është veçanërisht e rëndësishme në periudhën para zgjedhjeve që opinionet dhe informacionet e të gjitha llojeve të lejohen të qarkullojnë lirisht.

Me tej, GJEDNJ, në rastin Vajnai kundër Hungarisë, ka theksuar se: kur liria e shprehjes ushtrohet si fjalim politik, kufizimet justifikohen vetëm për aq sa ekziston një nevojë e qartë, urgjente dhe specifike sociale. GJEDNJ, rithekson se: ka pak hapësirë sipas nenit 10 paragrafit 2 të Konventës për kufizime në fjalimin politik ose në debatin e çështjeve me interes publik. Për me tepër, kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjera për një politikan si të tillë sesa për një person privat. Ndryshe nga ky i fundit, i pari në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije është i hapur ndaj një kontrolli të ngushtë të fjalëve dhe veprave të tij nga gazetarët,



dhe publiku i gjerë, dhe rrjedhimisht ai duhet të shfaqë një shkallë më të madhe tolerance, (Feldek kundër Sllovakisë).

Po ashtu, gjykata në rastin Nilsen dhe Johnsen kundër Norvegjisë, ka ritheksuar më tej se: liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për vetë përmbushjen e çdo individi. Andaj, edhe pse liria e shprehjes mund t'i nënshtrohet përjashtimeve, ato “duhet të interpretohen ngushtë” dhe “domosdoshmëria për çdo kufizim duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse”.

Duhet theksuar se me nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: “1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”.

Andaj në kontekstin e paraqitur duke ju referuar të cekurave më lart, rezulton se kategorizimi i shprehjeve të kandidatit të këtij subjekti politik, i shprehur në fushat si gjuhë që nxitë, provokon, apo që mund të nxisë apo të provokojë, një person tjetër për të kryer një akt dhune, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundër personave të tjerë ose pasurisë, është kategorizim jo adekuat e madje subjektin politik e vendos në pozitë të pafavorshme në raport me subjektet tjera politike sepse cenon frymën demokratike të fushatës e madje nëse është i pabazë kuptohet si cenim i lirisë së shprehjes.

Pozicionet e subjekteve politike përmes fushatës, pastaj edhe gazetarët lejohen në një masë ti shprehin bindjet dhe veprimtarin e tyre në emër të lirisë së shprehjes si e drejte fundamentale.

Për t'u kategorizuar një shprehje si gjuhë që nxitë, provokon, apo që mund të nxisë apo të provokojë, një person tjetër për të kryer një akt dhune, kundër personave të tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, duhet të plotësohen edhe elementi i cenimit të diskriminimit apo cenimit të sigurisë përmes pasojave që mund të ketë grupi apo individët brenda grupit.

Nga të cekurat më lart Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se PZAP, nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, prandaj ankesa e subjektit politik është aprovuar si e bazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është ndryshuar.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, dhe 34 paragrafi 1 pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.84/2025, datë 26.09.2025.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Kryetarja e kolegjit,
Franciska Zhitija - Ymeri
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Penëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-84/2025

FLETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PTAP - PRISHTINE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqjuit, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odaslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GYKIM 26.09.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Aktivi 29.09.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

14:35

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljava

Në rast se marrësi është anuluar ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaktun ose marrësi nuk e ka vend nënshkrimin. Atëherë primilac nëpërmjet tij u shpallu da se potpis, potpisuje ga dostava, napomenom: zasto primilac nije stavio svoj potpis.

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtati)